

KOSOVO



OLYMPIC
SOLIDARITY

AKADEMIA OLIMPIKE E KOSOVËS
KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS

FTESË PËR APLIKIM NË ASMC 5

Ju ftojmë që të aplikoni në kursin e avancuar për menaxhimin e Organizatave Sportive, i cili organizohet nga Komiteti Olimpik i Kosovës në bashkëpunim me Komitetin Olimpik Ndërkombëtar. Kursi i avancuar për menaxhimin e organizatave sportive është program i edukimit i cili zhvillohet nga Akademia Olimpike e Kosovës dhe ka për qëllim edukimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit në Federatat Sportive.



KURSI I AVANCUAR PËR MENAXHIMIN NË SPORT

Kursi i avancuar për menaxhimin e organizatave sportive olimpike do të zhvillohet në gjashtë module: Organizimi i një organizate sportive olimpike; Menaxhimi në nivel strategjik; Menaxhimi i burimeve njerëzore; Menaxhimi i financave; Menaxhimi i marketingut dhe organizimi i një ngjarje madhore sportive, si dhe punimi i temës përfundimtare dhe mbrojtja e saj. Ligjërimi do të realizohet në bazë të literaturës dhe praktikave më moderne në sport nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, dhe do të ligjërohet nga ekspert vendor dhe ndërkombëtarë. ASMC 5 do të filloj nga data 11 dhe 12 maj 2024 dhe do të përfundojë me diplomim në dhjetor 2024 me organizimin e prezantimit të punimit përfundimtar.

- Hapja e thirrjes: 5 prill 2024
- Mbyllja e thirrjes: 15 prill 2024
- Njoftimi për pjesëmarrje: 20 prill 2024
- Moduli i parë: 11-12 maj 2024
- Moduli i dytë: 22-23 qershor 2024
- Moduli i tretë: 31 korrik -1 gusht 2024
- Moduli i katërt: 28-29 shtator 2024
- Moduli i pestë: 26-27 tetor 2024
- Moduli i gjashtë: 23-24 nëntor 2024
- DIPLOMIMI: 20 dhjetor 2024

KRITERET PËR APLIKIM

Kandidatët të cilët aplikojnë për kursin e avancuar për menaxhimin e organizatave sportive duhet të kenë, të kryer kursin për administratorët sportiv, edukim të lartë profesional, njohjen e gjuhës angleze si dhe njohuri të programeve kompjuterike.

AFATI DHE DOKUMENTET PËR APLIKIM

Koha për aplikim do të jetë dhjetë ditë nga data e shpalljes 05.04.2024 deri më 15.04.2024 në ora 16:00h. Kandidati duhet të paraqesë këto dokumente: CV, letër rekomandimin nga organizata sportive, letërnjoftimin, kopje të diplomës universitare dhe kursit për administrator dhe kurseve tjera.

MATERIALET DHE KRITERET PËR PJESËMARRËSIT E KURSIT

Materialet e pjesëmarrësve përfshijnë literaturën e cila buron nga Libri “Menaxhimi i Organizatave Sportive Olimprike” e botuar në vitin 2020, materialet e secilit modul për mbajtje të shënimeve dhe përgatitja e prezantimeve. Pjesëmarrësit duhet të jenë prezent 100% në ligjërata, për secilin modul duhet të përgatiten rastet e studimit punimi përfundimtarë dhe të plotësohet testi për çdo modul.

PROCESI I PËRZGJEDHJES

Dokumentet e paraqitura nga kandidatët do të seleksionohen, ata të cilët kanë plotësuar kriteret do të i nënshtrohen intervistimit për të bërë përzgjedhjen e kandidatëve të sukseshëm, për çdo proces kandidatët do të njoftohen nëpërmjet email.



Propozimet të dërgohën në e-mail adresen:

secretarygeneral@noc-kosovo.org, më së largu deri
në datën **15.04.2024** në orën **16:00**